



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK VLORË

Nr. 146 Prot.

Vlorë, më 19.02.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Drejtuar: **DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit nr.759 datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Urdhrit Nr.226 datë 18.02.2025 "Për miratimin e numrit të instruktorëve dhe mësuesve me kohë të pjeshme për vitin 2025",

Qendra e Formimit Profesional Publik Vlorë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin "Sekretari" (me kohë të pjeshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin "Administrator ndërtesash" në Vlorë (me kohë të pjeshme);
- 2 (dy) instruktorë të praktikës profesionale në kursin "Manikyr-Pedikyr" (me kohë të pjeshme);
- 2 (dy) instruktorë të praktikës profesionale në kursin "Kuzhinë" në Vlorë (me kohë të pjeshme);
- 2 (dy) instruktorë të praktikës profesionale në kursin "Kuzhinë" në Sarandë (me kohë të pjeshme);

Adresa: Lagjia "Rilindja", Rruga "Riza Salati" – Vlorë/ Tel.+35533226759, email: qfplora@gmail.com

- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Parukeri” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Berberi” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Estetikë” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Web Design” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Instalim dhe mirëmbajtje e rrejtit elektrik” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Saldim” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Sipërmarrës dhe Menaxher i Biznesit të vogël” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Servis xhenerik në automjetet e lehta” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Udhërrëfyes turistik” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Menaxhim hoteli” në Sarandë (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Rrobaqepësi” (me kohë të pjesshme);

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës II të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet e të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Qendrës së Formimit Profesional Publik Vlorë, brenda datës 26.02.2025

